



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO  
ZYRA E PRESIDENTIT - URED PREDSEDNIKA - OFFICE OF THE PRESIDENT

Nr. Prof.: 608      Datë: 14, 06, 21  
Br. Prof.:              Datum:              /20

PRISHTINË/A

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission

14-06-2021

Prishtinë / Priština

Nr./Br. 1640-2021

Nr. i Vendimit: 42/2021

Presidentja e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L – 094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 47, 25 janar 2009), nenit 61 (paragrafi 5, pika d) të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (GZ, Nr. 31, 15 qershor 2008), dhe nenit 3 (paragrafi 4) të Rregullores (P) Nr. 02/2016 për strukturën organizative të Presidencës (08.09.2016), nxjerr:

## V E N D I M

1. Znj. Valdete Daka i ndërpritet mandati si Kryesuese e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

## A r s y e t i m

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organ kushtetues dhe i pavarur, i cili drejton dhe i verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve dhe gjithashtu i shpall rezultatet e tyre. Zgjedhjet si elementi më i rëndësishëm i demokracisë, sidomos asaj përfaqësuese, janë të një rëndësie të veçantë për secilin shtet. Ndërmarrja e veprimeve relevante në lidhje me zgjedhjet, përfshirë organizimin dhe mbarëvajtjen e tyre nënkupton edhe obligimin themelor të KQZ-së si organ menaxhues i zgjedhjeve.

Kriteri i të qenit organ i pavarur duhet të sigurohet nga të gjitha institucionet relevante dhe duhet të menaxhohet nga brenda nga Kryesuesi së bashku me anëtarët e KQZ-së. Kushtetuta parasheh që Kryesuesi i KQZ-së duhet të jetë një figurë e lartë gjyqësore, me një mandat burimor në Gjykatën e Apelit apo Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës. Një ndërlidhje e tillë ndërmjet funksionit aksesor të Kryesuesit të KQZ-së dhe mandatit burimor të tij është e natyrës imperative dhe të përhershme. Qëllimi i këtij parashikimi kushtetues është që Kryesuesi i KQZ-së t'i



nënshtrihen parasëgjithash parimit të paanshmërisë, si një garancion procedural dhe substancial që pozicioni i tij në menaxhimin e këshillimit dhe vendimmarrjes së KQZ-së të mos çenojnë integritetin objektiv të sistemit zgjedhor. Çdo gjyqtar i nënshtrohet parimit të paanshmërisë në ushtrimin e funksionit të tij sipas Nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, dhe, supozimi kushtetuese është që një parim i tillë përcaktues të jetë udhërrëfyes për mënyrën e sjelljes së Kryesuesit përgjatë ushtrimit të mandatit aksesor të tij në KQZ gjithashtu.

Në kuptim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, praktika gjyqësore e së cilës është e kushtetutëzuar me Nenin 53 të Kushtetutës, siç është vendosur në *Georgian Labour Party v. Georgia* (para. 82-83), është detyrë primare e çdo shteti që të mundësoj respektin për parimin e universalitetit dhe barazisë së votës dhe 'besimin' që duhet të ekzistoj në organin shtetëror që është veshur me kompetencë për të menaxhuar dhe vënë në funksion sistemin zgjedhor (Neni 3, Protokollin 1 i KEDNj-së). Pra, Kryesuesi i KQZ-së duhet të përputh sjelljen e tij me parimin e paanshmërisë në mënyrë që të siguroj pikë së pari 'besimin' e publikut në sistemin zgjedhor, dhe si rezultat edhe universalitetin dhe barazinë e votës. Çfarëdo sjellje nga Kryesuesi që nuk është në përputhje me parimin e paanshmërisë shkel në mënyrë të drejtëpërdrejtë një kriter procedural mbi të cilin ai është emëruar, dhe si rezultat, në kuptim të interpretimit në rastin *Georgian Labour Party v. Georgia*, edhe karakterin universal dhe të barabartë të sistemit zgjedhor. Meqenëse e drejta e votës në kuptim të KEDNj-së nënkupton jo vetëm autorizimin e individit por edhe mirëmbajtjen e një sistemi që garanton zgjedhje të lira dhe me integritet, çfarëdo cënimi i kësaj marrëdhënie përbën jo vetëm një bishtnim ndaj karakterit demokratik të sistemit zgjedhor por edhe të së drejtës në votë të qytetarit të Republikës së Kosovës. Fakti që diskrecioni përzgjedhës i Presidentes së Republikës është i lidhur me një kriter të tillë e detyron këtë të fundit që ajo, gjithashtu, të monitoroj vazhdimësinë e respektit për një parim të tillë nga ana e Kryesuesit të KQZ-së në mënyrë të vazhdueshme, e në veçanti në rastet kur karakteri praktik i të drejtës në votë bëhet objekt vendimmarrje në KQZ.

Përgjegjësia për ta ruajtur paanshmërinë e KQZ-së së pari është e Kryesueses së Komisionit. Kjo përgjegjësi i jepet Kryesuesit nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga vetë legjislativi në fuqi. Së pari, Kryesuesi e KQZ-së nuk vjen nga radhët e partive politike, por emërimi i tij bëhet me një proces të veçantë, fakt ky i cili tregon se Kryesuesi duhet të jetë i pavarur në veprimet e tij edhe kur brenda KQZ-së mund të ketë presione nga formacionet politike. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme parasheh se dëmtimi serioz i statusit dhe integritetit të KQZ-së është bazë për ndërprerje të mandatit edhe të Kryesuesit. Rrjedhimisht, ky ligj paraqet obligimin e Kryesuesit që të sigurojë se veprimet dhe sjelljet e tij në asnjë mënyrë nuk dëmtojnë statusin, besueshmërinë dhe integritetin e KQZ-së. Kjo bëhet për shkak se pavarësia e KQZ-së është kriter ligjor dhe në rast të mungesës së saj, dëmtohet statusi, besueshmëria dhe integriteti i KQZ-së. Së dyti, mandati i Kryesuesit të KQZ-së nuk lidhet me data të zgjedhjeve ashtu siç lidhet mandati i anëtarëve tjerë. Fakti se mandati i Kryesuesit zgjatë më së paku për disa palë zgjedhje, kurse mandati i anëtarëve tjerë mbaron me zhvillimin e zgjedhjeve të reja, tregon se përgjegjësia primare për të ruajtur



statusin e KQZ-së i takon Kryesuesit së saj. Përkatësisht, mos emërimi i Kryesuesit së KQZ-së nga propozimet e partive politike dhe mos ndërlidhja e mandatit të tij me mandatin e anëtarëve të tjerë tregojnë se bartës i funksioneve të KQZ-së dhe plotësimit të obligimeve ligjore, së pari është Kryesuesi i këtij organi. Pavarësia e KQZ-së, ruajtja e integritetit dhe e statusit janë kritere të lidhura me njëra-tjetrën, ndaj rrjedhimisht, mungesa e njërit e bën të pamundur përmbushjen e kriterit tjetër.

Kryesuesja e KQZ-së me veprimet e saj, sidomos përgjatë procesit të zgjedhjeve të parakohshme të 14 shkurt 2021, ka cenuar pavarësisë dhe integritetin e KQZ-së. Kryesuesja e KQZ-së, në shumë raste, nuk ka arritur të jetë forcë e pavarur ndaj polarizimeve politike kështu duke pamundësuar balancin e nevojshëm në këtë organ. Në fakt, në disa raste, sjelljet e Kryesueses janë të njëjta me ato të disa përfaqësuesve të partive politike në KQZ. Rrjedhimisht, Kryesuesja, qoftë me veprim apo mosveprim, ka kontribuar në përshkallëzim të situatës përgjatë mbledhjeve të këtij organi.

Të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës ishin dëshmitarë të presionit të paprecedent nga Kryesuesja kundrejt stafit të KQZ-së në mbledhjen e KQZ-së të datës 22 janar të vitit 2021. Një presion i tillë, fatkeqësisht, përsëri implikon ndikime të jashtme në vendimmarrjen e KQZ-së. Përkundër procedurave e propozimeve të qarta nga organet e KQZ-së, Kryesuesja e këtij institucioni nuk ka kryer punën e saj sipas standardeve profesionale e etike, të cilat janë të domosdoshme për të udhëhequr një institucion të tillë. Në këtë mënyrë, Kryesuesja e KQZ-së, duke ndikuar edhe tek anëtarët e tjerë, ka krijuar situatë të paprecedent, duke vënë në rrezik edhe afatet për proceset zgjedhore, të përcaktuara paraprakisht nga vetë KQZ-ja. Ndonëse mund të ketë tentime për ndikime në punën e KQZ-së, është detyrë e Kryesueses që të sigurohet se këto ndikime nuk depërtojnë në tavolinën e vendimmarrjes. Me depërtimin e këtyre ndikimeve, dëmtohet direkt puna e KQZ-së dhe i tërë procesi zgjedhor. Pra, ndikimet të cilat nuk janë në linjë me kriterin e pavarësisë ndikojnë seriozisht në dëmtimin e statusit dhe integritetit të KQZ-së.

Përveç këtyre që u përmendën më sipër, KQZ-ja në vazhdimësi është përballur me probleme pothuajse të njëjta në organizimin e zgjedhjeve, siç janë problemet me listën e votuesve, garantimin e të drejtës së votës së shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët jetojnë jashtë vendit, trajnimi adekuat i komisionerëve, edukimi i votuesve etj. Pavarësisht rekomandimeve të vazhdueshme nga ana e organizatave vendore e ndërkombëtare për përmirësim të procesit, KQZ-ja në vazhdimësi i ka injoruar këto probleme. Padyshim, barra kryesore institucionale bie mbi Kryesuesen e këtij institucioni.

Neni 24 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh se parimi i barazisë para ligjit është i një rëndësie të veçantë. Përkatësisht, të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës duhet të kenë trajtim të barabartë dhe në asnjë mënyrë të nuk mund përdoren strategji diskriminuese, të cilat aplikohen ndaj një grupi të caktuar. Vendosija e çfarëdo pengese për një kategori të caktuar në procesin e votimit përbën shkelje të Nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.



Fillimisht, u vendos një masë arbitrare, e cila kushtëzonte votuesit jashtë Kosovës që të përgjigjen në thirrjen e KQZ-së për t'u përfshirë në regjistrin e votuesve. E drejta për të votuar i përket secilit qytetar të Kosovës, i cili i plotëson kushtet ligjore, ndaj mohimi i kësaj të drejte ka një prag të lartë sipas legjislacionit në fuqi. Përkatësisht, mohimi i të drejtës për të votuar si e drejtë e cila garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës në asnjë mënyrë nuk mund të përcaktohet nga një vendim i KQZ-së. Në fund, vendosja e kësaj pengese rezultoi në pamundësinë e shqyrtimit të të gjitha aplikacioneve për votim jashtë Kosovës nga KQZ-ja. Sipas Procesverbalit Nr. 04, të datës 12 janar 2021, Kryesuesja e KQZ-së kishte mbështetur procedurën e verifikimit përmes telefonit. Për më tepër, sipas deklaratës së saj, ajo ishte e vetëdijshme se ky vendim ka ngritur "shqetësime të jashtëzakonshme" dhe se është "shumë i kontestueshëm nga të gjitha anët", por as kjo nuk e ndaloj për ta mbështetur dhe arsyetuar një veprim i cili tentonte të kufizonte në mënyrë procedurale dhe substanciale të drejtën e votës për një kategori të caktuar.

Së dyti, personat me të drejtë vote të cilët vendosën ta përdorin ankesën si mjet juridik ndaj këtyre vendimeve, kishin vetëm një (1) ditë afat për ta bërë këtë. Kjo situatë, ndër të tjera, rezultoi edhe në kufizimin e të drejtës së qytetarëve për ushtrimin e mjeteve juridike në një afat të arsyeshëm.

Së treti, trajtimi i pabarabartë i qytetarëve ndodhi edhe kur u lejua votimi duke përdorur dokumente me afat të skaduar. Kjo për arsye se KQZ-ja nuk mori parasysh se një vendim i tillë nuk mund të aplikohet te të gjithë qytetarët. Përderisa në gjysmë të ditës së zgjedhjeve qytetarët u lejuan të votojnë me dokumente me afat të skaduar, qytetarëve të cilët kanë votuar me postë i është dashur të përdorin dokumente valide. Ky veprim përveç se është në kundërshtim me parimet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës ngre dyshime të bazuara në integritetin e KQZ-së.

Së katërti, në faza të ndryshme gjatë proceseve zgjedhore, KQZ-ja nuk i ka ndërmarrë të gjitha masat për t'i parandaluar shkeljet ndaj Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Publikimi i të dhënave në disa raste kishte sjellë një numër të konsiderueshëm të ankesave në adresë të kryesueses, por këto nuk ishin parë si të arsyeshme nga ajo. Publikimi i dokumenteve të cilat përmbajnë të dhëna personale të qytetarëve është në kundërshtim me obligimet e KQZ-së për ruajtjen e tyre. Për më tepër, ky veprim përsëri kishte përfshirë kategorinë e njëjtë të votuesve si veprimet e mëparshme - votuesit jashtë vendit

Nga këto që u thanë më lart, vërehet se është përdorur një strategji diskriminuese ndaj një grupi të caktuar të votuesve. Shkaktarët për ndjekjen e kësaj strategjie në rastin më të mirë mund të kenë qenë gabimet profesionale kurse në rastin më të rëndë, qëllimet për të ndikuar në rezultatin zgjedhor. Vendosja e pengesave për të votuar, tentimi për mohim të së drejtës për të votuar, janë veprime të cilat dekurajojnë qytetarët për të votuar. Trajtimi i pabarabartë i qytetarëve gjatë procesit të votimit, kufizimi i të drejtës për ushtrimin e mjeteve juridike në një afat të arsyeshëm dhe mosndërmarrja e veprimeve për ruajtjen e të dhënave personale përbëjnë shkelje të parimeve

kushtetuese e ligjore. Veprimet e tilla, përveç se ulin besimin në KQZ, janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe më se të mjaftueshme për të ndikuar në statusin dhe integritetin e KQZ-së.

Legjislacioni në fuqi parasheh se Presidentja është autoriteti kompetent për të emëruar Kryesuesen e KQZ-së, sikurse edhe për ndërprerje të mandatit të saj. Ndaj, duke pasur parasysh vlerat demokratike të integruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh se pavarësia dhe integriteti i KQZ-së ka një rëndësi vitale në zgjedhjet demokratike dhe për t'u siguruar se ky integritet nuk dëmtohet më tutje, duke u mbështetur në faktin se zgjedhjet lokale të vitit 2021 pritet të organizohen së shpejti, dhe se në asnjë mënyrë Kryesuesja e KQZ-së nuk guxon të jetë shkak i humbjes së besimit qytetar në këtë institucion, kam vendosur sikurse në dispozitivin e këtij Vendimi.

Vjosa Osmani - Sadriu

Presidentë e Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 14.06.2021.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
2. Znj. Valdete Daka;
3. a/a.